



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni -III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 05-2008
Prishtinë, me 11 mars 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branislav Grbiq, Melihate Termkolli, Bajram Kosumi dhe Džezair Murati

Të ftuarit: Sherif Konjufca-Zyra për Informim, Ramadan Islami-OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Reshit Gashi-NDI, Haxhi Gashi-USAID, Robert Steere-NCSC, Fitore Zeneli-KDI, Lumnije Murati-ZPK.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 4 marsit 2008
3. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.
5. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për rendin e propozuar të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 4 mars 2008.

Kryetari në fillim i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit e tjerë, pastaj i pyeti për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

Bahri Hyseni - kryetar i Komisionit, theksoi se për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale fjalën do ta marrë ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, që do të na i ofrojë vërejtjet konkrete, pastaj fjalën do ta marrë raportuesi i Projektligjit, zëvendës kryesuesi i parë z. Adem Sailhaj.

Nekibe Kelmendi - theksoi se për ndryshimit dhe plotësimin të Projektligjit të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, arsyetimin e kam dhanë në seancën Plenare të datës 27 shkurt 2008.

Ajo tha se titulli i Projektligjit me fjalën “*të përkohshëm*” nuk është i përshtatshëm por me miratimin e Kushtetutës do t’i ndërrojmë edhe emërtimet e Projektligjeve.

Ministrja tha se ndryshimi i Projektligjit është rezultat i reformimit të legjislacionit penal, që ka filluar punën që dy vjet në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë: amerikanë, kanadezë dhe ekspertë vendorë siç janë: ekspertë të Odës së Avokatëve të Kosovës, Gjykatës Supreme, nga shoqata e gjyqtarëve, të juristëve. Kemi mbajtur takime që të përshpejtohen procedurat me qëllim që në kodin e procedurës penale të përfshihet edhe *Instituti i marrëveshjes për pranimin e fajit*. Me këtë rast do të favorizohet kryesi i veprës penale i cili përfiton me rastin e pranimit të fajit dhe dënimi i shqiptohet më i butë se me rastin e shqiptimit të sanksioneve konkrete. Mbajtja e dënimit fillon menjëherë dhe vendimi bëhet i plotfuqishëm ditën e marrëveshjes. Subjekt i marrëveshjes është në mes të prokurorit dhe të të akuzuarit.

Kryetari fjalën ia dha raportuesit të Projektligjit.

Adem Salihaj - e përshëndet ministren për kontributin që i ofron komisionit.

Vërejtjet e bëra në këtë projektligj, i prezanton para komisionit me shkrim.

Në mbledhjen e kaluar kemi miratuar paragrafin 3 të nenit 66 të Kodit Penal të Kosovës i cili ka imponuar ndryshimin dhe plotësimin e disa neneve të Kodit (të Përkohshëm) të Procedurës Penale të Kosovës. Futja e disa neneve të reja në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës që kanë të bëjnë me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe zbutjen e

dënimit paraqesin paqartësi dhe kolizion midis neneve të këtij projektligji dhe të vetë kodit.

1. **Neni 303, paragrafi 2** është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 66 të K(P)PK, sepse në paragrafin 5 të nenit 2 të KPPPK-së thuhet se kur i akuzuari pajtohet të pranojë fajësinë për veprë penale për të cilën mund të dënohet me një apo më shumë vjet, apo dënim afatgjatë, i akuzuari duhet të jetë i përfaqësuar nga mbrojtësi.

Në disa nene dhe aline lihet mundësia që i akuzuari të mos jetë i përfaqësuar nga mbrojtësi, ndërsa këtu kërkohet të jetë i përfaqësuar. Pra ka kolizion në mes neneve.

2. Po ashtu në **kapitullin XXII**, pas nenit 308, **shtohet neni 309**, në nënparagrafin (iii) thuhet se në interes të drejtësisë është lirimi i të akuzuarit nga dënimi i paraparë në nenin 303 të KPPPK-së. Kjo bie në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 303, ku është paraparë lirimi ose pezullimi i dënimit vetëm për ato vepra penale për të cilat është paraparë dënimi deri në 10 vite, por jo për dënimet mbi 10 vite..

Pra kemi kolizion ndërmjet neneve 303, paragrafi 2 i K(P)PPK-së dhe marrëveshjes së propozuar për pranimin e fajësisë, sepse dispozita e përmendur e K(P)PPK-së për lirim ose pezullim të dënimit, nuk e mundëson këtë për vepra penale, për të cilat parashihet dënimi mbi 10 vjet.

Në **nenin 309 paragrafi 15**, te fjalia “*Gjykata do ta pranojë marrëveshjen*”, propozoj të riformulohet fjalia “*Gjykata do ta marrë në shqyrtim marrëveshjen*”.

Siç është propozuar në paragrafin paraprak, marrëveshja për fajësinë, është lënë mundësia që të akuzuarit mund t’i pezullohet dënimi apo mund të lirohet edhe për vepra penale për të cilat parashihet *dënimi mbi 1 vit* apo edhe *dënim afatgjatë*, që do të thotë për dënimet në *kohëzgjatje prej 21 deri 40 vjet*.

Kërkoj të sqarohet çështja, se a mund të zbuten dënimet edhe për veprat penale deri në 40 vjet burgim apo vetëm për veprat penale deri në 10 vjet burgim.

Po ashtu është i paqartë **neni 309, paragrafi 17**, ku thuhet “në rast se dispozitat e këtij neni janë në kundërshtim me dispozitat e tjera të K(P)PPK-së, këto dispozita kanë përparësi”, pra duhet të sqarohet se cilat janë këto dispozita në këtë nen.

3. Gjithashtu marrëveshja e propozuar mbi pranimin e fajësisë është në kundërshtim me **nenin 303, paragrafët 4 dhe 5**. sepse në paragrafin 5 thuhet se gjyqtari mund ta revokojë urdhrin për dëshmitarin bashkëpunues, nëse ai akuzohet si organizator apo udhëheqës i grupit prej dy apo më shumë personash.

Pra nuk vlen marrëveshja e pranimit të fajësisë për të gjitha rastet, vlen vetëm për raste të veçanta. Nëse i akuzuari në një grup apo organizatë terroriste, sipas këtij paragrafi, gjyqtari nuk mund ta revokojë urdhrin për dëshmitarin bashkëpunues.

4. Në **paragrafin 6 të nenit 300**, thuhet se për veprat penale, për të cilat parashihet dënimi mbi 10 vjet, nuk mund të jepet urdhri për bashkëpunim me këtë dëshmitar.

Pra ka shumë kundërshtime në nene dhe për këtë arsye sponsoruesit duhet të ofrojnë sqarime.

5. Në **nenin 4** të këtij projektligji, aty ku flitet për nenin 309, pika 1, nënpika (ii), të hiqet pjesa e fjalisë “*përfshirë atë që është nën minimumin e parashikuar me ligj*”.

Pra, jemi kundër që të akuzuarit t’i zbutet dënimi edhe nën minimumin e parashikuar me ligj, sepse kjo do t’u hapte mundësi prokurorit dhe gjykatës ta dënojë një kriminel, që ka

kryer vepra të rënda penale, vetëm me disa muaj burgim, ndërsa për ato vepra penale parashihet dënimi deri në 40 vjet burg.

6. Në **nenin 4** të këtij projektligji, ku është shtuar neni 309, në paragrafin 4 të këtij neni, rreshti i nëntë, duhet të hiqen fjalët “*prokurori publik*”, sepse janë përsëritur pa nevojë. Te paragrafi 15, i po këtij neni, te rreshti i katërt, ku thuhet “*gjykata do ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë*”, të thuhet: “*gjykata mund ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë*”. Pra, të mos jetë detyrim për gjykatësin.

7. **Neni 7** i këtij projektligji të jetë i formuluar: “*Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi që paraprakisht është aprovuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës*”.

Arsyetim: Gjykatave dhe prokurorive duhet t’u jepet një afat prej 30 ditësh që të përgatiten për aplikimin e tij.

Përfundim; Ai konstatoi se është e nevojshme të bëhen këto ndryshime dhe plotësime që projektligji të jetë i aplikueshëm dhe t’i arrijë efektet juridike.

Adem Hajdari - tha se projektligjet janë të shkruara me shumë gabime drejtshkrimore. Përdorimi i trajtave të shkurtra në tekstin e Projektligjit jep kuptim tjetër. Për shembull në nenin 309 paragrafi 11, paraqet paqartësi si për gjykatën ashtu edhe për të akuzuarin. Kur është fjala për përkthimin e Projektligjeve, hartuesit po i marrin ligjet prej gjuhës angleze, me ç’rast emrat e përgjithshëm i shkruajnë me shkronja të mëdha dhe këtë praktikë po e interpretojnë edhe tek ne, kurse sipas rregullave drejtshkrimore të gjuhës sonë, fjalët “e këtij Kodi, të këtij Ligji” duhet të shkruhen me shkronja të vogla. Sa i përket Projektligjit, në nenin 2, paragrafi 5, në rreshtin e fundit, fjalia “*kur gjykata lejon që procedura të vazhdojë pa mbrojtje*”, propozoj që të zëvendësohet me fjalinë “*i akuzuari mund të lirohet edhe kur këmbëngul që të mos ketë mbrojtës*”, pra i akuzuari mund të mbrohet edhe vetë, pa iu caktuar mbrojtësi.

Riza Smaka – theksoi se emërtimi i projektligjeve është i shkruar gabim, duhet të hiqet fjala “*projektligj*” dhe të zëvendësohet me fjalën “*projektkod*”.

Ai propozoi që në nenin 7, duhet të hiqet “*dhe*”, sepse nuk kuptohet se ligji hyn në fuqi në ditën e miratimit apo në ditën e shpalljes.

Ai propozoi që **neni 7** të riformulohet: “*Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit të kryetarit të Kosovës*”.

Ai propozoi të shtohet fjala “*vacatio legës*”, që nënkupton se *ligji hyn në fuqi 8 ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare*.

Kryetari - dha sqarime rreth hartimit të projektligjeve. Ai theksoi se hartuesit e projektligjeve duhet ligjet t’i hartojnë në gjuhën shqipe e pastaj t’i harmonizojnë në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe.

Sa u përket projektligjeve, duhet të bazohemi në vërejtjet përmbajtjesore.

Në Kodin e procedurës penale, me rëndësi është të shqyrtohet çështja e dënimeve deri në 10 vjet dhe dënimeve afatgjata - mbi 10 vjet, sepse kjo paraqet kolizion në mes neneve dhe për këtë kërkojmë sqarim nga Ministria e Drejtësisë.

Në **nenin 309**, theksoi se gabimisht është shkruar në tekstin e paragrafit 3: “*ta informojë kryeprokurorin në zyrën e tij*”, duhet të riformulohet: “*të informohet kryeprokurori në institucionin përkatës*”.

Në **nenin 309, paragrafi 4**, thuhet “*dëshmitari duhet të bëhet informator i përhershëm i policisë*”. Kjo i kalon suazat e humanitetit dhe për këtë çështje kërkohet sqarime nga propozuesit.

Çështje tjetër me rëndësi është që para se të bëhet leximi i parë i projektligjeve, duhet të vijin në Komision, të shqyrtohen se a kanë nevojë për ndryshim apo plotësim të neneve.

Adem Salihaj – theksoi se në Kuvendin e Kosovës e kemi miratuar në parim Projektligjin e K(P)PPK-së, por vetëm me ndryshimin e paragrafit 3 të nenit 66.

Ai shtoi se me futjen e disa neneve të reja në KPPK-së që kanë të bëjnë me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe zbutjen e dënimit, sipas kësaj marrëveshje shkakton disa paqartësi dhe kolizion midis neneve të këtij projektligji dhe të vetë Kodit.

Nekibe Kelmendi – tha se është shumë vonë që Projektligji t’i kthehet Qeverisë pasi është bërë leximi i parë në Kuvendin e Kosovës.

Ajo theksoi se në vitin 2001 ia kemi dërguar Zyrës Ligjore një projektкод penal shumë mirë të punuar, në të cilin si subjekt mbrojtjeje janë përfshirë Trupat Mbrojtës të Kosovës, kufiri, territori i Kosovës, por zyra ligjore e UNMIK-ut e ka ndryshuar këtë kod me arsyetimin se po paragjykohet statusi i Kosovës.

Ajo shtoi se vërejtjet e paraqitura në Projektligj janë me vend, mirëpo këto vërejtje nuk i ka marrë me kohë dhe për këtë arsye nuk mund të ofron sqarime. Ajo propozoi që në afat prej një jave t’i dorëzohen me shkrim, procesverbali i mbledhjes së sotme dhe transkripti i seancës së Kuvendit të Kosovës. Pasi ta bëjmë krahasimin e ligjit, vërejtjet do t’i dërgojmë me shkrim.

Pastaj propozoi të mbahet dëgjim publik për tri projektligjet dhe vërejtjet e dala nga dëgjimi, Komisionit do t’i shërbejnë për ndryshim dhe plotësim të këtyre projektligjeve.

Kryetari – iu përgjigj kërkesave të ministres, se stafi i Komisionit pasi ta përgatitë procesverbalin dhe njëkohësisht ta sigurojë transkriptin e seancës plenare, do t’ia dërgojë Ministrisë së Drejtësisë.

Sa u përket tri projektligjeve, atyre u është bërë leximi i parë në Kuvendin e Kosoves dhe për këtë arsye Komisioni ka vendosur të mos mbajë dëgjim publik.

Dëgjime publike do të organizohen për; Projektligjin për procedurën kontestimore, për procedurën jokontestimore, për procedurën përmbartimore dhe për Projektligjin për noterinë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike u vendos që propozimet e marra nga Ministria e Drejtësisë të shqyrtohen në njërin nga mbledhjet e radhës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale

Bahri Hyseni – tha, pasi jam referues i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, paraqes këto vërejtje:

Në **nenin 1, paragrafi 30**, fjala “*regjistër*” të mbetet dhe në fund të tekstit të shtohet fjalia “*dhe në kartonin personal të të dënuarit*”.

Në **nenin 2**, të mos plotësohet **neni 31** i Projektligjit për ndryshime dhe plotësime.

Në **nenin 3**, në **paragrafin 38.4**, të hiqet fjala “*korrektesë*” të zëvendësohet me fjalën “*korrektues*”.

Në tërë tekstin e Projektligjit, fjala “*riedukim*” të zëvendësohet me fjalën “*risocializim*”.

Në **nenin 6**, fjala “*komisionari*”, propozon që në tërë tekstin e Projektligjit të zëvendësohet me fjalën ‘*Ministria e Drejtësisë*’.

Nga neni 7 deri në **nenin 21** të miratohen propozimet dhe ndryshimet në Projektligj.

Projektligjet kanë gabime gjuhësore me ç’rast do t’i dërgojmë për lekturim dhe korrigjim.

Në **nenin 22 (neni 124)**, propozon që fjala “*dhe hekurave për këmbë*” të mos miratohet, por fjala “*dhe prangat*” të harmonizohet me gjuhën shqipe dhe angleze.

Nga neni 23 deri në **nenin 26** të miratohen propozimet dhe ndryshimet e Projektligjit.

Neni 27 (neni 135 dhe 136) miratohet. Propozon në rastet ku është përdorur fjala doktor të zëvendësohet me fjalinë “*mjek specialist nga fusha përkatëse*”.

Në **nenin 136.1**, propozon të hiqet pika (b), ndërsa në fund të pikës (a) të shtohet fjalia “*jashtë vendit*”.

Ai parashtrori një problem me rëndësi dhe shtoi se në Projektligj fare nuk është përfshirë kapitulli mbi “*ekzekutimin e sanksioneve në gjykatën për kundërvajtje*”.

Mungesa e kësaj dispozite paraqet pengesë të madhe për gjyqtarët, se ligji i aplikueshëm e ka ç’shfuqizuar Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje të Serbisë. Në shumë raste gjyqtarët urdhëresat i lëshojnë pa u bazuar në ligj.

Nekibe Kelmendi – dha sqarim për shqyrtimin e dënimit me burgim. Procedura e ankesës shkon deri në tri shkallë. Së pari atakohet aktvendimi i shkallës së parë të gjykatës komunale, pastaj atakohet ai në shkallë më të lartë dhe sipas procedurës së rregullt aty duhet të marrë fund. Por sipas Ligjit për kundërvajtje kur dikush dënohet (i cili dënim është 60 ditë), me ankesë i lejohet t’i drejtohet Gjykatës Supreme dhe ajo merr vendim. Vendimi i Gjykatës Supreme shqiptohet njësoj si vendimi i gjykatave të tjera për ekzekutimin e sanksioneve.

Ajo pajtohet me problemet që paraqesin anëtarët e Komisionit dhe propozon të shkruhet amendament i veçantë lidhur mbi “*ekzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje*”.

Riza Smaka – propozoi se në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale duhet të ekzistojë një nen i veçantë për kundërvajtje ku në procedurë të rregullt me aktvendim gjykata cakton burgim për të pandehurin.

Propozon se në emërtimin e projektligjeve të hiqet “*për*” dhe të zëvendësohet me “*mbi*”.

Pas diskutimeve për këto dy pika u konstatua se:

Komisioni, pasi t’i ketë marrë vërejtjet nga Ministria e Drejtësisë, në afat prej dy javësh, raportuesit Bahri Hyseni dhe Adem Salihaj duhet të raportojnë lidhur me këto dy projektligje.

5. Të ndryshme

Kryetari – shtoi se në të ndryshme, do të diskutohet për mbajtjen e dëgjimeve publike.

Ai tha se dëgjimi i parë për Projektligjin për Procedurën kontestimore do të mbahet pas dy javësh.

Ai tha se për dëgjim publik do të thërrasim përfaqësues nga shoqëria civile, gjykata komunale, Gjykata Supreme, shoqata e juristëve, Oda e Avokatëve, Fakulteti Juridik, përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit dhe përfaqësuesit nga NDI-ja, OSB-ja, USAID-i.

Kur është fjala për dëgjim Publik me rëndësi është organizimi i çështjes teknike. Përfaqësuesit duhet të njoftohen një javë me parë dhe njëkohësisht duhet t'u dërgohet shkresa përcjellëse dhe projektligji.

Komisioni propozoi se shkresa përcjellëse duhet të përgatitet me këto pika:

- 1. Vërejtjet e përgjithshme**
- 2. Vërejtjet konkrete dhe**
- 3. Propozimet.**

Selvije Halimi –tha se sipas praktikës për organizimin e dëgjimit publik duhet të ftuarve t'u dërgohet më herët shkresa përcjellëse së bashku me projektligjin. Të ftuarit duhet të ofrojnë vërejtje lidhur me Projektligjin, pastaj ne si anëtarë të Komisionit mund vetëm të parashtrijmë pyetje e të mos zhvillojmë debat. Vërejtjet e tyre që i paraqesin me gojë dhe me shkrim, pastaj ne në Komision i shqyrtojmë.

Kryetari – shtoi se ne si Komision gjithsesi do t' i përmbahemi rendit të ditës. Ai propozoi të caktohet një raportues për shqyrtimin e Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Njëzëri u miratua propozimi që raportues të caktohet Riza Smaka dhe pas një jave të raportojë në lidhje me këtë projektligj. Gjithashtu t'u bëhet ftesë propozuesit dhe një përfaqësuesi të Kryeministrit për të marrë pjesë në mbledhjen e së njëjtës ditë.

Kryetari- Theksoi se sërish është shpallur konkursi për pozitën e Ombudspersonit dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, gjithashtu, është përgjegjës për intervistimin e kandidatëve që do aplikojnë për këtë pozitë. Ai më tutje propozoi që javën e ardhshme të formohet një komision në lidhje me këtë çështje

Propozimi u miratua njëzëri.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

Procesverbalin e hartoi:
Drita Çarkaxhiu, zyrtare ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni